

VENDIM
Nr. 525, datë 22.9.2021

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRIT TË SHETIT PËR STANDARDET E SHËRBIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës të përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse harton, bashkërendon dhe zbaton politikat shtetërore që synojnë standarde të larta të shërbimeve publike, të ofruara për ushtrimin e të drejtave të qytetarëve dhe përmirësimin e jetesës, lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike, sigurimin e cilësisë dhe përballueshmërisë së tyre.

3. Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, harton, zhvillon dhe monitoron politikat shtetërore dhe strategjitë për:

- a) sigurimin e standardeve në ofrimin e shërbimeve publike;
- b) rritjen e cilësisë së shërbimeve në çdo sektor publik;
- c) lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike;
- ç) rritjen e efektivitetit të shërbimeve për të garantuar aksesin e qytetarëve në marrjen e shërbimeve publike.

4. Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve koordinon dhe monitoron hartimin e standardeve dhe bashkëpunimin midis institucioneve të administratës shtetërore që ofrojnë shërbime publike.

5. Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve koordinon dhe, rast pas rasti, udhëheq procesin e riinxhinierimit dhe derregullimit, me qëllim thjeshtimin, rritjen e eficiencës dhe të efikasitetit të shërbimeve publike të ofruara nga institucionet e administratës shtetërore.

6. Ngarkohet ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE
Arben Ahmetaj